



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ /2018

V E N D I M

Nr. 57, Datë 13 / 2 /2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me Nr.129, datë 13.10.2017, e paraqitur nga B.M, kundër Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Mat, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike” dhe “çdo shkak tjetër”¹.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

KONSTATOI:

Sipas shprehimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe dokumentacionin shoqërues, nga B.M, pretendohet se është diskriminuar nga titullari i institucionit, duke e larguar nga puna dhe duke mos i ofruar një detyrë e një niveli më të ulët, pasi cilësohet si person i dënuar dhe i politizuar pasi aderon në një subjekt politik. Referuar Librezës së Punës, B.M nga data 14.05.2014 deri më datë 10.04.2017 ka qenë i punësuar pranë Shërbimit Spitalor Mat, në detyrën e Përgjegjës të Sektorit Mbështetës. Me shkresën nr.357, datë 29.03.2017 është njoftuar nga punëdhënësi mbi fillimin e procedurës së zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, pasi pozicioni “Përgjegjës Sektor” pranë Shërbimit Spitalor Mat, përfshihej në fushën e veprimit të nenit 2, pika 1, germa b, të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksionet publike” dhe Vendimit të Kuvendit nr.17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, rikthimin në detyrë si specialist ekonomist ose në një detyrë të një niveli më të ulët.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen dhe ka kërkuar nga ankuesi shpjegime, dokumentacion dhe informacion më të plotë.

¹ Si person i dënuar me vendim të formës së prerë.

- Për këtë arsye, me shkresën nr. 954/2, datë 24.10.2017, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ka kërkuar ankuesit të paraqesë këto dokumente: -Fakte dhe prova për të provuar shkakun e diskriminimit të pretenduar dhe shpjegime që do të provonin trajtimin e pabarabartë në raport me punonjësit e tjerë të trajtuar nga ligji nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” i ndryshuar, nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Mat.

B.M ka marrë dijeni për shkresën me anë të: Lajmërim marrje poste nr. RR 091 535 918 AA datë 26.10.2017.

Subjekti ankues, me gjithë afatin kohor që kishte në dispozicion, nuk përmbushi kërkesat ligjore për dërgimin e informacionit të kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur. Ankuesi në rastin në fjalë nuk ka paraqitur fakte apo prova për të vërtetuar bindjen politike dhe për të dhënë shpjegime se për shkak të bindjeve të tij politike të kundërta me drejtuesit e institucionit është larguar nga puna.

Në analizë të shkakut, të pretenduar nga ankuesi “çdo shkak tjetër”² për largimin e tij nga puna dhe jo uljen në detyrë, në mbështetje të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksionet publike”, i ndryshuar, Komisioneri vlerëson se, bazuar në nenin 15/3³ të ligjit nr.138/2015, përcaktohet se funksionarët që preken nga neni 2 pika 1/b të ligjit të sipërcituar zbatohen procedurat për shkarkimin nga detyra dhe në asnjë nen të këtij ligji nuk është parashikuar ulja në detyrë.

² Si person i dënuar me vendim të formës së prerë.

³ Trajtimi i funksionarëve publikë aktualë: 3. Nëse provohet se ekzistojnë rrethanat për ndalimin e zgjedhjes apo emërimit, zbatohen procedurat e nevojshme kushtetuese apo ligjore për mbarimin e mandatit apo shkarkimin nga detyra.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33/2, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç, 7 dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës të shtetasit B.M për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI